




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjilan, me datë: 13.09.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1.1 pika (b) të lidhur me nenin 61.2 të Rregullorës Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, duke vendosur sipas Kërkesës për Rishqyrtim të datës 08.09.2023 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Gartten – GJ” Sh.p.k. për aktivitetin e prokurimit me titull: **“Punë publike – projektet e vogla në infrastrukturë” me numër prokurimi 651-23-8976-5-1-1**, mori këtë:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e paplotë Kërkesa për Rishqyrtim e Operatori Ekonomik “Gartten –GJ” Sh.p.k. e parashtruar me datë 08.09.2023 me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me materialo Hixhienik - Sanitar” me Nr. të Prok: 651-23-394-1-1-1**, inicuar nga AK Komuna e Gjilanit.
- II. **VËRTETOHET** Njoftimi mbi Publikimin për Kontratë i Autoritetit Kontraktues i dt. 24.08.2023 për aktivitetin e prokurimit **“Punë publike – projektet e vogla në infrastrukturë” me numër prokurimi 651-23-8976-5-1-1**, dhe AK – Komuna e Gjilanit vendsosë të vazhdojë më tutje me procedurën e prokurimit të përcaktuar si në pikën një dhe dy të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik Ekonomik “Gartten –GJ” Sh.p.k. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ar sy e t i m

Operatori ekonomik Ekonomik "Gartten –GJ" Sh.p.k. si palë e pakënaqur me datë 08.09.2023 ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim në AK- Komunën e Gjilanit kundër njoftimit të kontratës ose me dokumentet e tenderit përkitazi me aktivitetin e prokurimit me titull: "Punë publike – projektet e vogla në infrastrukturë" me numër prokurimi 651-23-8976-5-1-1, me arsyetimin duke i cituar dispozitat ligjore të LPP-së nga neni 7, neni 51 dhe neni 25 i këtij ligji.

Autoriteti Kontraktues, Komuna e Gjilanit përmes Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, konform nenit 108/A paragrafi 6 të LPP-së gjatë vlerësimit preliminar të Kërkesës për Rishqyrtim të parashtruesit, ka gjetur se kërkesa e OE ankues është e paplotë për shkak se në pjesën e formularit të deklaratës detale mbi faktet dhe argumentet nuk është përshkruar asnjë fakt apo rrethanë me të cilën mbështeten supozimet për shkeljet e dispozitave të LPP-së.

Andaj, AK duke vepruar sipas nenit 61.2 të Rregullorës për Prokurim Publik Nr.001/2022 i ka kërkuar me shkrim OE ankues "Gartten –GJ" Sh.p.k. që ta plotësojë kërkesën e tij sipas nenit 60.3 të kësaj rregullore duke i përshkruar faktet dhe argumentet për secilin pretendim dhe secilës shkelje të supozuar, në afat prej dy ditësh nga marrja e kërkesës, respektivisht deri me datën 13.09.2023 në ora 11:30.

Duke qenë se parshtruesi i Kërkesës për Rishqyrtim OE "Gartten –GJ" nuk e ka plotësuar kërkesën sipas elementeve dhe përmbajtjes të detyrueshme që përcaktohen me nenin 60.3 pika e dhe f të Rregullorës për Prokurim Publik Nr.001/2022, Autoriteti Kontraktues duke u bazuar në nenin 61.2 të kësaj rregullore vendosi që kërkesa e OE "Gartten –GJ" të refuzohet si e paplotë. Dhe duke vepruar në pajtueshmeri me nenin 63.1.1 pika b e kësaj rregullore Autoriteti kontraktues vazhdon më tutje me aktivitetin e prokurimit duke vlerësuar dhe konsideruar arsyet e refuzimit dhe rrethanat në të cilat ndodhet aktiviteti i prokurimit.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna më lart, Autoriteti Kontraktues ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


Kujtim Bajrami
Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit
Komuna e Gjilanit

Kopje:

- Operatorit Ekonomik ankues "Gartten –GJ"
- Zyrës së Kryetarit të Komunës;
- Te gjitha palëve të interesuara;